

PËRGATITJA PËR KOLONOSKOPI

TREGIMI I SANDRËS



Urime!

Nëse po konsultoheni me doktorin për planifikimin e një kolonoskopie ekzaminuese, një procedurë e cila rekomandohet të kryhet rreth moshës 50 vjeçare për të konfirmuar gjendjen e mirë të zorrës së trashë, ju keni ndërmarrë një hap të rëndësishëm drejt sigurisë së shëndetit për veten dhe familjen tuaj.

Arsyeja për ta ndërmarrë këtë vendim të rëndësishëm

Kanceri i zorrës së trashë prek burrat dhe gratë e të gjitha racave dhe grupeve etike dhe haset më shpesh te personat nga mosha 50 vjeçare e lart. Mesatarisht, rreth një në 23 persona do të preket nga kanceri i zorrës së trashë në jetën e tij. Zbulimi i hershëm gjatë kolonoskopisë mund t'ju ndihmojë që të parandaloni formimin e kancerit të zorrës së trashë.*

Procedura e kolonoskopisë është mënyra e vetme ekzaminuese që mund të parandalojë vërtet kancerin e zorrës së trashë në kohën e ekzaminimit. Kjo arrihet, sepse gjatë kolonoskopisë, doktori mund të heqë polipe, zmadhime të vogla që mund të zhvillohen në kancer nëse nuk trajtohen, përpara se ato të kthehen në kancer. Procedura e kolonoskopisë zgjat rreth 30 minuta dhe është procedurë ambulatorie, që do të thotë se ju do të shkoni në shtëpi, në të njëjtën ditë që kryhet procedura.

Si të përgatiteni për një kolonoskopi ekzaminuese

Ky tregim me figura, që ka si personazh Sandrën, është krijuar për t'ju ndihmuar që të përgatiteni për kolonoskopinë. Sandra është një prej mijëra individëve që janë ekzaminuar në qytetin e Nju Jorkut vitin e kaluar. Duke lexuar historinë e Sandrës, ju do të mësoni si më poshtë:

- Arsyet e kryerjes së kolonoskopisë
- Si të përgatiteni për kolonoskopinë, duke përfshirë informacion rreth përgatitjes së zorrëve, një proces që përshin marrjen e ilaçeve nga goja, zakonisht në formë të lëngshme ose tablet
- Çfarë duhet pritur përpara dhe pas kolonoskopisë

Faqja e fundit e këtij tregimi me figura përmban më shumë informacion dhe mjete për t'ju ndihmuar që të përgatiteni, duke përfshirë një listë me pyetje që mund ta merrni me vete në vizitën e ardhshme te doktori.

* Grupi i Punës i SHBA-së për Statistikat rreth Kancerit. Statistikat e Kancerit në Shtetet e Bashkuara: Raport interneti për rastet dhe vdekshmërinë në periudhën 1999-2014. Atlanta, GA: Departamenti i Shëndetit dhe Shërbimeve Njerëzore i SHBA-së, Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve dhe Instituti Kombëtar i Kancerit; 2017. E disponueshme në cdc.gov/uscs.

TRE DITË PËRPARA KOLONOSKOPIË

NË DYQAN

LISTA E USHQIMEVE


- Lëng nollë
- Ujë arre kokosi
- Lëng xhenxhefil
- Pije sportive
- Çaj
- Kafë
- Lëng pule

*Asgjë me ngjyrë
të kuqe, blu ose
vjollcë

PA TË SHOHIM... ÇFARË
DUHET TË MARR QË
TË PËRGATITEM PËR
KOLONOSKOPINË?
INFERMIERJA MË THA TË
MOS MARR ASNJË USHQIM
OSE PIJE TË KUQE, VJOLLCË
OSE BLU. ASGJË QË MUND
TË NGJAJË ME GJAKUN
NË ZORRË.

NËSE NUK SHOH DOT
PËRTEJ, NUK MUND
TA KONSUMOJ.
LËNGU I MOLLËS
DUHET TË JETË
I PRANUESHËM.

...TANI TË MARR
SOLUCIONIN E
PËRGATITJES
SË ZORRËVE...



OU... KJO
ENË KAQ E
MADHE ËSHTË
PËR SOLUCIONIN
E PËRGATITJES
SË ZORRËVE?

PO. DO TË
TË PASTROJË
ZORRËN E TRASHË.

DHE KY
AROMATIZUES DO
TA NDIHMOJË QË
TË KETË SHJE
MË TË MIRË.



SI DO TË JETË
PROCEDURA? EDHE
ARON E KA BËRË
MË PARË. NDOSHTA
MË TREGON AI...



Të gjitha kontaktet

Aaron

Abbott

Alex

Ali

Art



ALO?
PO SANDRA.
SI JE?

EJ, ARON. A BËRE
NJË EKZAMINIM PËR
KANCERIN E ZORRËS
TË TRASHË TI PAK
MË HERËT?

PO. KOLONOSKOPIA
NUK ISHTE AQ E RËNDË.
MOS U SHQETËSO PËR
PROCEDURËN. PJESA
E VËSHTIRË ËSHTË
PËRGATITJA E ZORRËVE.

PSE?

KAM PIRË SHUMË.
PASTAJ MU DESH TË
SHKOJA NË BANJË PËR
ORË TË TËRA. 15 HERË
SPRINT 50 METRA.



OU... NUK E DJA
QË PËRGATITJA
E ZORRËYE KISHTE
KAQ PUNË.

MUND TË MARRËSH
MË SHUMË
INFORMACION NGA
KOORDINUESJA. TA
DHA KARTËVIZITËN,
APO JO? BËJI NJË
TELEFONATË!

JA, TANI.
FALEMINDERIT, ARON!



Kejti Smith
Koordinatore kolonoskopie

Telefon: 555-536-7689
Email: katie.smith@cp.co

PËRSHËNDETJE, JAM SANDRA.
DO TË BËJ NJË KOLONOSKOPI
PAS DISA DITËSH DHE DO TË DOJA
PAK MË SHUMË INFORMACION
RRETH PËRGATITJES.

PATJETËR, MUND TA SHPJEGOJ PROCESIN HAP PAS HAPI. ËSHTË RELATIVISHT E THJESHTË, DUHEN MBAJTUR MEND TRE GJËRA KRYESORE:

- 1. MBAJ DIETË VETËM ME LËNGJE TRANSPARENTE NJË DITË PËRPARA.**
- 2. PIJE TË GJITHË LËNGUN E PËRGATITJES SË ZORRËVE.**
- 3. THUAJI DIKUJT TË TË ÇOJË NË SHTËPI.**



**FYTYRA KUR
TË THOTË
DIKUSH QË
NUK HA
DOT USHQIM
TË THATË
GJITHË DITËN.**



DY DITË PËRPARA KOLONOSKOPIË

DUHET TË
ZGJEDH DIETËN
E LËNGJEVE.
TË SHOH SE
ÇFARË KAM...

NË RREGULL...
MUND T'IA DAL.




**PËRSHËNDETJE,
JAM SANDRA.**

**O, Ç'KEMI SANDRA?
KE NDONJË PYETJE?**

**VETËM DIETË ME
LËNGJE TRANSPARENTE
NESËR, NË RREGULL?**

**PO. DHE TË TË
KUJTOJ PËR ILAÇET...**

**NUK DO TË MARR
ASNJË ILAÇ SOT,
SIÇ MË THA DOKTORI.**



MË DUHET
NDIHMJA JUAJ NESËR.
ËSHTË PËR EKZAMINIMIN
E KANCERIT TË ZORRËS
SË TRASHË.

MOS U SHQETËSO,
SANDRA. DO TË
TË LËMË TË SHKOSH
E PARA NË BANJË.

NUK DO TË
HAMË PARA TEJE.
DHE UNË DO TË
TË SHOQËROJ!

JENI MË
TË MIRËT.

PSHERËTIMË... SHPRESOJ QË TË MOS
KEM KANCER. EKZAMINIMI PËR KANCER DO
TË JETË I VËSHITRË, POR DUA TË RUAJ
SHËNDETIN. NDOSHTA NJË GJUMË I MIRË DO
TË MË NDIHMOJË TË QARTËSOJ MENDJEN...

NJË DITË PËRPARA KOLONOSKOPISË

HERËT NË MËNGJESIN
TJETËR



Prit... NUK DUHET
BULMET. NËSE
NUK SHOH DOT
PËRTEJ, NUK MUND
TA KONSUMOJ.

DREKË, ATË DITË MË YONË...

TË BËFTË
MIRË!

DO TË HAMË EDHE
NE TË NJËJTËN
GJË ME TY!


JU FALEMINDERIT!
NUK DO T'IA DILJA
DOT PA JU.

JE MIRË? NUK KE
NGRËNË USHQIM TË
THATË GJITHË DITËN.

NDIHEM MIRË. KËTO
ISHIN MJAFTUESHËM.




PRA, DUHET VETËM
QË TË SHTOJ
UJË TE SOLUCIONI
I PËRGATITJES
SË ZORRËVE...



DHE PASTAJ PAK
AROMATIZUES QË TË
RREGULLOJË SHIJEN...



DO TA PISH
TË GJITHË ATË?



GJYSMËN. PJESA TJETËR
ËSHTË PËR NESËR
NË MËNGJES HERËT.



PO JEP NJË SHEMBULL
TË MIRË PËR FAMILJEN,
SANDRA.

PO, KISHTE. KJO MË MOTIVOI QË
TA BËJA KËTË. MË MIRË TA GJEJ
HERËT SESA SHUMË YONË.

MBAJ MEND QË
GJYSHI YT KISHTE
KANCER.

EDHE DJALI
YT DUHET TË
EKZAMINOHET.
AI SAPO MBUSHI
51 VJEÇ.

OH. KOHA PËR
"SPRINTIN 50 METËRSH
DERI NË BANJË"...





SA HERË DO TË
NDODHË KJO?

DHJETË HERË,
NDOSHTA MË SHUMË.
KËSHTU NDODHI DHE
ME BABANË TËND KUR
BËRI KOLONOSKOPINË.

BABI KA BËRË
KOLONOSKOPI?
HM...



DITA E KOLONOSKOPISË



DUHET TË MBAROJ SË
PIRI PJESËN TJETËR TË
LËNGUT TË PËRGATITJES
SË ZORRËVE.





GATI PËR
KOLONOSKOPINË,
ZEMËR?



PATJETËR! MOS HARRO,
NUK MË LËNË QË TË KTHEHEM
NË SHETËPI PA SHOQËRUES!



MOS U SHQETËSO, DO TË
VIJ UNË QË TË TË MARR!
PASTAJ DO TË MË
TREGOSH SE SI ËSHTË.

MIRË SE ERDHËT! DAKORD, PRA TRE GJËRA:
SË PARI, KENI ARDHUR PËR KOLONOSKOPI?

Po.

SË DYTË, A KENI PIRË
OSE NGRËNË NDONJË
GJË SOT NË MËNGJES?

PJESËN E MBETUR
TË LËNGUT TË PËRGATITJES
SË ZORRËYE NË
ORËN 5 TË MËNGJESIT.
PASTAJ, ASGJË.

PERFEKTE. SË TRETI,
A KENI NDONJË PERSON
QË DO T'JU ÇOJË
NË SHTËPI?

Po. BURRIN TIM.

SHUMË MIRË.
DO T'JU NJOFTOJ
KUR DOKTORI TË JETË
GATI QË T'JU TAKOJË!





DO T'I SHIKONI
FOTOGRAFITË
E ZORRËS SË
TRASHË KËTU.

SI ISHTE LËNGU
I PËRGATITJES
SË ZORRËVE?

E PNA TË GJITHË DHE DJE
KAM MARRË VETËM LËNGJE
TRANSPARENTE. NDIHEM E PASTËR
DHE BOSH.

SHUMË MIRË. TANI, KY QETËSUES DO T'JU
VENDOSË NË GJUMË DHE MUND TË MOS
E MBANI MEND KOLONOSKOPINË MË YONË.
JENI GATI PËR PROCEDURËN?

JAM GATI.

NË DHOMËN E PRITJES...

EJ! MBAROYA!

SI NDIHESH?

**E ÇLIRUAR! POR,
KAM PAK URI.**





EJ, SANDRA! ME SA
DUKET, PROCEDURA
SHKOI MIRË. THJESHT
DOJA T'JU KUJTOJA
QË TË PRISNI PËR TË
MARRË FOTOGRAFITË.
DUHET TË JENË GATI
PËR NJË ORË.

DHE MOS HARRONI:
MOS PINI ALKOOL SOT.
DHE MOS BËNI PLANE TË
MËDHA PËR MBRËMJEN!
THJESHT PUSHONI.



JU FALEMINDERIT PËR TË
GJITHË NDIHMËN! MË VJEN
MIRË QË E BËRA KËTË.
NDIHEM MIRË QË PO
INVESTOJ PËR SHËNDETIN.

DUKET MIRË.
NDOSHTA DUHET
TA BËJ EDHE UNË...

PAS KOLONOSKOPISË

DO TË BËJME
NDONJË GJË PËR QEJF?
TË BËSH PAZAR?


JO SOT.
JO PLANE TË
MËDHA, E MBAN
MEND?

PO, E DREJTË...
PRA, SI ISHTE?

MIRË. INFERMIERJA
MË THA QË ARRITËN
TË BËNIN FOTOGRAFI
TË TË GJITHË
ZORRËS SË TRASHË.
DERI NË FUND.

ÇFARË
PANË?

NUK KA POLIPE
OSE FRYRJE QË
MUND TË JENË
KANCER.



SA URI
KAM...



SANDRA, DO TË
TË GATUAJ USHQIMIN
E PREFERUAR
SONTE!




FALEMINDERIT!
MEZI PO PRES!

KJO IA YLENTË
TË GJITHË MUNDIN.



JEMI SHUMË
KRENARË PËR TY,
SANDRA!

NDOSHTA DUHET TË
KONTROLLOHEM EDHE
UNË PËR KANCERIN E
ZORRËS SË TRASHË.



PO TI,
KUR DO TA BËSH?

PYETJE PËR DOKTORIN

1. Çfarë lëngu për përgatitjen e zorrëve duhet të marr përpara procedurës së kolonoskopisë?
2. Çfarë ilaçesh të tjera duhet të marr përveç lëngut për përgatitjen e zorrëve?
3. A duhet t'i ndaloj ilaçet që marr, përpara procedurës?
4. Sa kohë pushim duhet të marr nga puna që të përgatitem për kolonoskopinë?
5. Çfarë qetësuesi do të marr gjatë kolonoskopisë?
6. Sa zgjat kolonoskopia?
7. Çfarë ndodh nëse gjejnë polip?
8. Sa shpesh duhet ta bëj kolonoskopinë?
9. Kush tjetër në familje duhet të ekzaminohet?
10. Çfarë duhet të bëj nëse nuk ndihem mirë menjëherë pas procedurës?

MIRËNJOHJE

Redaktorë:

Departamenti i Shëndetit dhe Higjienës Mendore i Qytetit të Nju Jorkut
(NYC DOHMH)

Sonia Angell, MD, MPH

Jennifer Brown, PhD

Shadi Chamany, MD, MPH

Kim Kessler, JD

Justin List, MD, MAR, MSc

Sonia Villegas, MA

Rrjeti i Koordinatorëve të Pacientëve të Kolonoskopisë i NYC DOHMH

Konsulentë:

Maryse Georges, MPH

Richard Rosenberg, MD, New York-Presbyterian

Elizabeth Tedrow, MPH

Benjamin Tsang, Ilustrues

